

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik / Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Titulli i lëndës:	E drejta e procedurës penale- Pjesa e posaçme
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obliguar
Viti i studimeve:	Viti III - Semes.VI - 2022/23
Numri i orëve në javë:	3 (tri)
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	E marte 9.00 – 11.30.
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr.Azem Hajdari
Detajet kontaktuese:	Viti III azem.hajdari@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>E drejta e procedurës penale- Pjesa e posaçme është pjesë e shkencës juridike penale e cila i kontribuon luftës së suksesshme kundër kriminalitetit. Në bazë të plan-programit mësimor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, lënda- E – drejta e procedurës penale- Pjesa e posaçme, si lëndë e obligueshme në vitin akademik 2023/2024, e cila ligjërohet në semestrin e gjashtë, përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive mbi çështjet që i referohen procedurave penale (të rregullt, procedurave alternative dhe procedurave të veçanta) dhe fazave të zhvillimit të tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, e cila si pjesë e shkencës juridiko- penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. Programi mësimor nga lënda E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktik (nëpërmjet ligjëratave, përpilimit e shkresave proceduralo- penale, seminareve, debateve dhe diskutimeve me studentë). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studentëve, që si jurist të ardhshëm me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme me natyrë proceduralo- penale, të përpilojnë me lehtësi shkresat proceduralo- penale, të adresojnë drejtë çështjet që lidhen me kompetencat e organeve të procedurës penale dhe</p>

	kështu t'i kontribuojnë luftës parandaluese të kriminalitetit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Me trajtimin e njësive të caktuara të së Drejtës së procedurës penale, Pjesës së posaçme, studentëve u ofrohet materia përkatëse që u mundëson atyre të kuptojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe përmbajtjet kryesore shkencore. Vëzhgimi i aktiviteteve të studentëve dhe debatet e zhvilluara në këtë fushë, me trajtimin e rasteve konkrete nga praktika e organeve procedurale penale, ka për qëllim aftësimin e studentëve në lëmin e kësaj shkence. Në sistemin e mësimit zbatohen metodat e shtjellimit të lëndës ashtu që organizohen debate, teste, seminare e kolokviume me qëllim të nxitjes së punës aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Me këto metoda mësimore, studenti që kryen fakultetin juridik aftësohet me njohuri themelore rreth mënyrës së veprimit të gjykatave dhe organeve tjera të procedurës penale në zgjidhjen e drejtë të çështjeve penale. Vlerësimi i studentit gjatë kohës së ligjëratave bëhet edhe me testim. .</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të elaborojnë fazat e procedurës penale dhe autorizimet e subjekteve të procedurës penale në kuadër të tyre; 2. Të elaborojnë procedurat penale alternative, procedurën penale për të mitur (specifikat e saj) dhe procedurat penale të posaçme, 3. Të hartojë shkresa të ndryshme me natyrë proceduralo- penale, 4. Të kualifikojë veprat penale dhe të bëjnë zgjidhjen e çështjeve penale konkrete. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	15
Punë praktike	1	5	05
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	05
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	5	5	25

Detyra të shtëpisë	5	5	25
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	10	10
Projektet, prezantimet etj.	1	10	10
Totali	22	98	215

Metodologjia e mësimdhënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në pjesën më të madhe të kohës do të mbahen ligjërata interaktive, që do me thënë, që përveç ligjërimit të mësimdhënësit, kyçen edhe studentët duke u pyetur, diskutuar, këmbyer mendimet mbi çështjet tematike që janë objekt i ligjërates. 2. Punimet seminarike përcaktohen sipas zgjedhjes së studentit. Atyre u ofrohen udhëzime se si duhet përgatitur seminarët. Pastaj bëhet dorëzimi i punimit seminarik, mësimdhënësi e kontrollon atë, pastaj në orët e caktuara mësimore, lexohet nga studenti dhe hapet diskutimi lidhur me to. 3. Ushtrime në përgatitjen e një çështje penale konkrete. Simulohet rasti i caktuar, studentëve u shtrohet detyra që të përgatisin një ankesë apo aktgjykim, e pastaj hapet diskutimi dhe komentohet çështja.
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes zbatimit të këtyre metodave:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Provimeve. 2. Kolokviumeve, 3.Prezantimeve, 4.Punimeve seminarike, 5.Pjesëmarrjes në debate etj.
------------------------------	--

Literatura	
Literatura bazë:	Hajdari A. & Hasani F. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2022.

	<p>Hajdari A., E drejta e procedurës penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë,2013.</p> <p>Sahiti E. dhe Murati R, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2013.</p> <p>Hajdari A., E drejta e procedurës penale e të miturve, Prishtinë, 2005.</p>
Literatura shtesë:	<p>Samaha J., Criminal procedure, Boston, 2014,</p> <p>Rolando V. Criminal Procedure: Law and Practice, New York, 2016,</p> <p>Swanson Ch. Criminal Investigation, London, 2014,</p> <p>Fausto I. E drejta procedurale penale, Përkthim, Tiranë, 2002.</p> <p>Grigor Gj. Procedura penale e RPSH, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970,</p> <p>Grubač M. Krivično procesno pravo, Posebni deo, Beograd, 2004,</p> <p>Hajdari A. Komentar- Kodi i procedurës penale, Prishtinë, 2016,</p> <p>Hajdari A. E drejta e procedurës penale- Komentar, Prishtinë, 2010.</p> <p>Islami H. etj. Procedura penale, Tiranë,2003,</p> <p>Matovski N. Kazнено procesno pravo, Skopje, 2004,</p> <p>Nova K.Proçedura penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966,</p> <p>Panta M. Komentarot na zakonot za krivičnata postopka, Skopje, 1979,</p> <p>Pavišić B. etj.Zakon o kaznenom postupku, Zagreb, 1998,</p> <p>Sahiti E. Murati R., Elshani Xh., Komentar – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2014,</p> <p>Sierčić Č. Krivično procesno pravo, Sarajevo, 2005</p> <p>Stevanović Č i dru. Krivično posebno pravo, Beograd, 1997.</p>
Plani i dizejnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Nocioni dhe lënda e studimit të pjesës së posaçme të së drejtës së procedurës penale, marrëdhëniet midis pjesës së përgjithshme dhe të posaçme të së drejtës së procedurës penale, sistemimi dhe stadet e procedurës penale
Java e dytë:	Pozita e policisë në procedurën paraprake, hetimi (kuptimi, qëllimi dhe kohëzgjatja), pezullimi, pushimi dhe përfundimi i

	hetimit dhe mundësia hetuese e veçantë
Java e tretë:	Aktakuza dhe shqyrtimi i saj
Java e katërt:	Shqyrtimi gjyqësor (kuptimi dhe rëndësia), përgatitjet për shqyrtim gjyqësor, parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, drejtimi i shqyrtimit gjyqësor
Java e pestë:	Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe rrjedha e shqyrtimit gjyqësor
Java e gjashtë:	Aktgjykimi (kuptimi dhe llojet e aktgjykimit), shpallja e aktgjykimit dhe përpilimi me shkrim i aktgjykimit Kolokviumi I
Java e shtatë:	Mjetet juridike (kuptimi dhe llojet), mjetet e rregullta juridike- ankesa (kuptimi i ankesës, përmbajtja dhe arsyet e ushtrimit saj)
Java e tetë:	Procedura e ankimimit, vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën, rigjykimi i çështjes në gjykatën themelore, “Beneficium cohesionis” dhe “Reformation in peius”, ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe ankesa kundër aktvendimit
Java e nëntë:	Mjetet e jashtëzakonshme juridike
Java e dhjetë:	Procedurat alternative
Java e njëmbëdhjetë:	Procedura ndaj të miturve- kuptimi i kriminaliteti i të miturve dhe i procedurës penale për të mitur dhe përbërja e trupit gjykues për të mitur dhe emërimi i gjyqtarëve
Java e dymbëdhjetë:	Kompetenca e gjykatës në procedurën penale për të mitur, arrestimi i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi në procedurën penale për të mitur dhe rrjedha e procedurës penale për të mitur Procedurat gjyqësore që përfshijnë kryerjen e veprave penale ndaj fëmijëve, veprat penale që është i autorizuar ti gjykoj trupi gjykues për të mitur ose gjyqtari për të mitur, kompetenca territoriale e gjykatës kur gjykohen të miturit dhe karakteristikat tjera të procedurës penale për të mitur
Java e trembëdhjetë:	Procedura për revokimin e dënimeve alternative, procedura për shlyerjen e dënimit nga evidenca e të ndëshkuarve, procedura për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe ekzekutimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në çështjet penale
Java e katërbëdhjetë:	Procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimor, procedura për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, procedura për shqiptimin e

	masave të trajtimit të detyrueshëm, procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm rehabilitues ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës
Java e pesëmbëdhjetë:	Procedura për kompensim të dëmi, rehabilitim dhe ushtrim të të drejtave tjera të personave të dënuar pa arsye ose arrestuar pa arsye, procedura për dhënien e letërrreshtimeve dhe shpalljeve publike Kolokviumi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Përmes punës me student do të arrihet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës, 2. Avancojë zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës; 3. Ndhimohet në procesin e promovimit të demokracisë qytetare; 4. Krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe kërkimeve shkencore; 5. Zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe kreativ etj. 	